VENDIM
Nr. 98, datë 27.10.2014

PËR PËRFUNDIMIN E ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18, pika 5, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr. 96, datë 27.10.2014, si dhe nr. 97, datë 27.10.2014, për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014,

konstatoi se:

- Në bazë të vendimit nr. 5, datë 21.1.2013, aktiviteti i shpërndarjes dhe ai i furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike kryhet aktualisht nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) në administrim të përkohshëm;

- Me vendimet nr. 96, datë 27.10.2014, si dhe nr. 97, datë 27.10.2014, Bordi i Komisionerëve vendosi licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionarëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 21.1.2013.

2. Shfuqizimin e akteve nënligjore të mara në zbatim të vendimit nr. 5, datë 21.1.2013.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti